



UK Health  
Security  
Agency

# Rreth tuberkulozit (TB)

Tuberkulozi është një sëmundje infektive që zakonisht prek mushkëritë. Ai shkaktohet nga bakteret. Tuberkulozi mund të jetë një sëmundje serioze, por është i trajtueshëm me antibiotikë.

## Si infektohemi nga tuberkulozi (TB)

Kur një person me simptoma të tuberkulozit kollitet ose teshtin, ai/ajo lëshon në ajër pika të vogla që përmbajnë baktere. Është e vështirë të infektohesh me tuberkuloz. Duhet të keni kontakt të ngushtë dhe të rregullt me personin e infektuar dhe të thithni ajrin e kontaminuar. Ekzistojnë dy lloje të tuberkulozit: aktiv dhe latent.

## Tuberkulozi aktiv

Kjo do të thotë se bakteret janë aktive në trupin tuaj. Ju:

- keni simptoma,
- mund ta transmetoni infeksionin,
- ndiheni të sëmurë.

## Simptomat e tuberkulozit aktiv

Këshillohuni me një mjek të përgjithshëm GP (sipas akronimit nga anglishtja) nëse keni:

- kollë që nuk përmirësohet,
- nxjerrë mukus (gëlbasë) që përmban gjak
- temperaturë ose djersitje gjatë natës,
- mungesë oreksi ose humbje në peshë,
- lodhje të theksuar.

## Tuberkulozi latent

Kjo do të thotë se bakteret nuk janë aktive në trupin tuaj. Ju:

- nuk keni simptoma,
- nuk mund ta transmetoni infeksionin.

## Tuberkulozi është i trajtueshëm.

Nëse infektoheni nga tuberkulozi, në Mbretërinë e Bashkuar do të përfitoni analiza dhe trajtim falas.

## Testet për tuberkulozin

Mund të kryeni testin edhe nëse nuk keni asnjë simptomë.

Mjeku mund të përdorë një ose disa teste në kombinim për të verifikuar nëse jeni i/e prekur nga tuberkulozi. Ato përfshijnë:

- një radiografi të krahavorit,
- një analizë lëkure,
- një analizë gjaku,
- një mostër të mukosit (gëlbasës).

## Kush mund të preket nga tuberkulozi

Çdokush mund të preket nga tuberkulozi, por rreziku është më i lartë nëse:

- kaloni shumë kohë me një person që ka tuberkuloz aktiv,
- keni jetuar në një vend ku tuberkulozi është më i përhapur,
- keni një sistem imunitar të dobët,
- jetoni në kushte të mbipopulluara ose të pashëndetshme,
- pini duhan, konsumoni rregullisht alkool ose përdorni substanca narkotike,
- keni pasur më parë tuberkuloz që nuk është trajtuar siç duhet.

## Vaksina kundër tuberkulozit

Ekziston një vaksinë kundër tuberkulozit. Ajo quhet BCG (Bacillus Calmette-Guérin). Vaksina BCG nuk jepet si pjesë e vaksinimit rutinë të programit të vaksinimit të shërbimit kombëtar shëndetësor (NHS, sipas akronimit anglisht) pasi rekomandohet vetëm për personat me rrezik më të lartë. Për më shumë informacion rreth vaksinës, vizitoni faqen e internetit të NHS-së: [nhs.uk/vaccinations/bcg-vaccine-for-tuberculosis-tb/](https://nhs.uk/vaccinations/bcg-vaccine-for-tuberculosis-tb/).

## Mësoni më shumë rreth tuberkulozit.

Shikoni video informuese mbi tuberkulozin latent në 7 gjuhë të ndryshme në YouTube. Kërkoni kanalin [@TheTruthAboutTB](https://www.youtube.com/@TheTruthAboutTB).

Vizitoni faqen e internetit të NHS-së ose skanoni barkodin QR për më shumë informacion rreth tuberkulozit: [nhs.uk/conditions/tuberculosis-tb/](https://nhs.uk/conditions/tuberculosis-tb/).

